



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



02/ Nr. 558
Data: 20.01.2023

PROCESVERBAL I TAKIMIT TË EKIPIT PËR MBROJTJEN E FËMIJËS

Procesverbali nga mbledhja e Bordit të Drejtorëve të komunës së Hanit të Elezit, mbajtur me datë 27.12.2022 me fillim pune në ora 10:00 në zyrën e Sallën e Takimeve në katin e parë të objektit të Komunës. Të pranishëm ishin: **Mehmet Ballazhi** (Kryetar i Komunës), **Kimete Kuka - Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Lindita Ballazhi** (Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport), **Nuhi Dema** (Komandant i Policisë), **Amir Bushi** (Udhëheqës i QPS-së), **Vjosa Rogaqi** (Zyrtare për Barazi Gjinore)

Takimin e kryesoi Kryetari i Komunës **z.Mehmet Ballazhi**, i cili fillimisht evidentoi se në takim nga grupi punues mungon Florim Shkreta (Kryesues i Kuvendit), Resul Suma (Anëtar i Kuvendit Komunal) dhe Visar Hasallari (përfaqësues i KVRL).

RENDI I PUNËS

1. Takim njoftues i Ekipit për të Drejtat e Fëmijës në kuadër të Komunës.

Mehmet Ballazhi thekson: Ne kemi marrë një vendim, pra vendim nga Kryetari i Komunës për themelimin dhe funksionimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës, i cili rregullohet me UDHËZIMIN ADMINISTRATIV (QRK) NR. 06/2022 PËR THEMELIMIN DHE FUNKSIONIMIN E EKIPIT PËR TË DREJTAT E FËMIJËS, ekip ky përbërjen e të cilit e rregullon po ky UA, ku është e përcaktuar prej 10 anëtarësh, Kryetari si Kryesues, Drejtoritë përkatëse, Zyra për Barazi Gjinore, Kuvendi dhe KVRL, ku secili i ka përgjegjësitë e ndara, sipas pozitës që mban.

Amir Bushi: Neve ky njoftim për formimin e ekipit na ka ardhë fillimisht nga MAPL, e cila është e përcaktuar, edhe me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, me Udhëzim Administrativ dhe me Rregullore Komunale, ku siç e keni parë te UA, Kryesues është Kryetari i Komunës, kurse zv.Kryesues është Drejtoresha e Mirëqenies Sociale, dhe siç edhe jemi dakord, ky takim i sotëm është vetëm takim informues rreth formimit të ekipit, vendim të cilin veçse e kam dërgu në Ministri, e më pas Ministria kanë me ma kthyer një feedback se si me vepru më tutje dhe unë mendoj se për vitin e ardhshëm ne duhemi me u përgatit për me e bërë një plan të punës vjetore që duhet me u miratu edhe në Kuvend, si dhe çdo tre muaj të bëhen takime. Sot kisha propozu që në janar të vitit 2023 me e caktu një takim, dhe disa ose dikush prej nesh me e marrë përsipër me e bërë një plan pune si draft, jo shumë të ngarkum, ose nëse jeni ju dakord unë mund të kontaktoj edhe me komunat e tjera.

Vjosa Rogaqi: Plani i punës është për një periudhë 3 vjeçare dhe miratohet në Kuvend, rëndësi që kemi ku bazohemi meqë kemi edhe Udhëzimin Administrativ, ta marrim si mostër dhe atëherë punojmë të gjithë tek plani.

Hisni Luri: Në cilësinë e Drejtorit të DKA-së, e kemi edhe obligim ofrimin e edukimit dhe arsimimit për fëmijët dhe do të mundohemi që ta arrijmë në maksimum, ku edhe me politikat e reja të arsimit, janë në procedura me u bo obligative edhe arsimi parafillor dhe i mesëm.

Kimete Kuka: Do të përkushtohemi maskimalisht që si tek sektori i Shëndetësisë dhe te Mirëqenia Sociale, të japim mbështetjen tonë për ekipin për mbrojtje të fëmijëve.

Lindita Ballazhi: Edhe në aspektin e buxhetimit, unë do të ofroj mbështetjen time sidomos gjatë planifikimit të buxhetit ku e kemi linjën e veçantë për mirëqenie sociale në kuadër të DSHMS-së, por edhe sjelljen e donatorëve të huaj, ku sipas planit që do ta përgatisim, do të diskutojmë dhe të ofrojmë mjete enkas për aktivitetet që do të kryhen në kuadër të Planit të ekipit për mbrojtjen e fëmijëve.

Mehmet Ballazhi: Atëherë, Amiri e merr përsipër përpilimin e planit të punës, në takimin e radhës e diskutojmë, modifikojmë dhe e nxjerrim planin përfundimtar dhe kur ta shohim të arsyeshme, e qesim në Kuvend për miratim.

Mehmet Ballazhi: A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, kalojmë në pikën e radhës sipas agjendës.

Mbledhja përfundoi në ora 10:22.

Procesmbajtësja
Liridona Ballazhi



Kryetari i Komunës
Mehmet Ballazhi

